VENDIM
Nr. 29, datë 28.2.2019

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HIDRO VIZION" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "RAZDOLL", ME FUQI TË INSTALUAR 700 KW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 6, germa "b", të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike",* i ndryshuar, nenit 4, pika 2, germa "a" dhe nenit 10, pika 3, të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa "a", të *"Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, vendim të Bordit të ERE-s nr. 153, datë 11.12.2015, *"Mbi operimin në treg të prodhueseve me kapacitet të instaluar nën 1 MW dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike",* Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019 pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hidro Vizion" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hidro Vizion" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Razdoll" me fuqi të instaluar 700 KW, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Shoqëria "Hidro Vizion" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 131 prot., datë 7.2.2019, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Razdoll", me kapacitet të instaluar 700 KW.

- Nga aplikimi i vihet re se HEC "Razdoll", për të cilin kërkon të licencohet subjekti "Hidro Vizion" sh.p.k., ka një kapacitet të instaluar 700 kW, pra, më të vogël se 1 MW.

- Ligji nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, i ndryshuar, në nenin 37, pika 6, germa "b", parashikon: *"Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike: …b) prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW".*

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 153, datë 11.12.2015, "*Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 MW dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike"* ka vendosur:

1. Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.

2. Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajisen me licencë nga ERE.

3. Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast që fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.

- Aplikuesi pas paraqitjes në OSHEE të dokumentacionit të nevojshëm, teknik, administrativ dhe ligjor, nuk ka asnjë pengesë për të nënshkruar kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me të ngarkuarin me detyrimin e shërbimit publik, sipas VKM, nr. 244, datë 30.3.2016, "*Mbi kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".*

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Hidro Vizion" sh.p.k., në veprim-tarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Razdoll", me fuqi të instaluar 700 KW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi